

Бр.:/Nr: 17-1850/11

22.04.2020 год./viti
КИЧЕВО - KËRÇOVË

KOMUNA E KËRÇOVËS

Në bazë të Programit për aktivitetet e Komunës së Kërçovës në lëminë e Sportit dhe Rekreimit në vitin 2026 ("Fletorja Zyrtare e Komunës së Kërçovës" nr. 1/2026), Komuna e Kërçovës shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2026, të destinuara për mbështetjen e shoqatave sportive dhe ekipeve

Shpërndarja e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2026, në pajtim me Programin nga lëmia e Sportit dhe Rekreimit nr. 08-453/9 të dt. 29.01.2026, mjetet e destinuara për financimin e aktiviteteve të shoqatave sportive dhe ekipeve, do të bëhet në bazë të kriterit dhe përparësive të dhëna në këtë thirrje.

1. Lloji i projekteve që do të mbështeten

Mjetet nga Buxheti i Komunës së Kërçovës, do të shfrytëzohen për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave sportive dhe ekipeve, për projekte nga këto kategori:

Komponenta 1

Mbështetjen e projekteve dhe aktiviteteve për ngritjen e nivelit të ekipeve sportive; mbështetjen e projekteve për ngritjen e nivelit të sporteve luftarake; mbështetje për shkollat sportive, projekte të cilat ndikojnë për të rritur ndërgjegjen e sportit integruar në mesin e komuniteteve.

Komponenta 2

Organizimi i fushatave për potencim të jetës së shëndoshë dhe jetesës së shëndoshë
Organizimi i aktiviteteve të sporteve tradicionale.

2. Mjetet e parapara

Për financimin e aktiviteteve programore të ofruara, në pajtim me thirrjen, do të shfrytëzohen mjete nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2026, në shumë të përgjithshme prej **5.350.000,00 den.**

I. Për përkrahjen e shoqatave sportive dhe ekipeve sportive, nëpërmjet projekteve nga lëmia e prioriteteve të radhës:

1. Mbështetje të projekteve dhe aktiviteteve për ngritjen e nivelit të ekipeve sportive në territorin e Komunës së Kërçovës;
2. Mbështetje të projekteve për ngritjen e nivelit të sporteve luftarake në territorin e Komunës së Kërçovës;
3. Përkrahja për shkollat e sportit;
4. Ngritjen e vetëdijes për sport të integruar ndërmjet bashkësive në territorin e Komunës së Kërçovës;

II. Përkrahje të sportistëve dhe aktiviteteve tjera për sport dhe rekreacion

1 Organizimi i fushatave për potencim të jetës së shëndoshë dhe jetesës së shëndoshë

2 Organizimi i aktiviteteve të sporteve tradicionale.

3. Dorëzimi i raportit

Shoqatave sportive dhe ekipeve të cilëve do t'ju jepen mjete në pajtim me Programin, pas përfundimit të aktiviteteve të veta programore, do të dorëzojnë raport për shfrytëzimin e mjeteve, deri te Sektori për financa dhe Buxhet në Komunën e Kërçovës, dhe Komisioni për Sport.

4. Kriteret themelore organizative

Kriteret themelore organizative, të cilët duhet t'i përmbushin shoqatat sportive dhe ekipet të cilat do të marrin pjesë në këtë thirrje janë:

- Kapaciteti i organizatës
- Relevanca e aksionit të ndërmarrë
- Efektet në mjedis
- Qëndrueshmëria e projektit
- Pjesmarrja vetanake në kofinancim (me kohë, pajisije, burime njerëzore)
- Konsistenca e projektit (qëllimet, aktivitetet, rezultatet, buxheti)
- Ndarja e sakt e rolit të partnerëve
- Subjektet patjetër duhet të veprojnë në territorin e Komunës së Kërçovës.

5. Dokumentacioni i nevojshëm të cilin shoqatat/sportive duhet ta dorëzojnë me Paraqitjen për mbështetje financiare të shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve

Shoqatat dhe fondacionet të cilat marrin pjesë në shpallje, duhet të paraqesin:

1. Fletëparaqitje për mbështetje financiare;
2. Buxhet aplikimin;
3. Aktvendim për regjistrimin e shoqatave dhe ekipeve;
4. Kopje të llogarisë së transakcionit
5. Raport për mjetet e fituara nga Buxheti i Komunës së Kërçovës në vitin e kaluar fiskal dhe mënyrën e realizimit të tyre (nëse shoqata ka qenë shfrytëzuese e mjeteve të ndara nga Buxheti i Komunës së Kërçovës për vitin 2025);

Vërejtje:

1. Paraqitjet e dokumenteve të pa plotësuara pas përfundimit të afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen! Shtojcat e dorëzuara nuk do të kthehen.

2. Paraqitjet që do të jenë të plotësuara me dorë nuk do të shqyrtohen.

3. Nëqoftëse fitoni mjete financiare nga buxheti I Komunës së Kërçovës, keni obligim në të gjitha materialet (të shkruara dhe elektronike) që do të jenë të kuadër të manifestimit/ngjarjes, projektit nga lëmia e sportit në vend të dukshëm të qëndrojnë:

Përkrahur nga
Komuna e KËRÇOVËS

6. Propozim për mbështetje financiare deri te Kryetari jep komisioni i formuar për realizimin e Thirrjes Publike.

Aktvendimi i Kryetarit është DEFINITIV

7. Shoqatat e sportit dhe ekipet kanë të drejtë të aplikojnë me 1 projekt.


8. Afati dhe mënyra e dorëzimit të paraqitjes

Afati për dorëzimin e paraqitjeve është deri më **dt. 15.05.2026**

Paraqitja me dokumentacionin gjithëpërfshirës, të dorëzohet përmes Arkivës së Komunës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, me etiketën - **Për mbështetjen e shoqatave sportive dhe ekipeve për vitin 2026.**

Shoqatat sportive dhe ekipet pjesmarrëse në thirrjen publike, do të jenë të informuara për rezultatet nëpërmjet njoftimeve që do të ju dorëzohen në adresat e të njejtave. Emrat e shoqatave sportive dhe ekipeve të cilat kanë fituar mjete për projektet, do të publikohen në faqen elektronike të Komunës së Kërçovës. Paraqitjet për mbështetje financiare të shoqatave sportive dhe ekipeve dhe formulari për Propozimprojektin, do të mund të merren në internet faqen e Komunës së Kërçovës: web.kercova.gov.mk

Përgaditi: Valdet Selimi



Antarë Komisioni:

Kryetar:

Darko Beleski



Antarë:

1. Valdet Selimi



2. Daniel Gjurchinoski

